

# “BUTONI EMERGJENT” NË GJORÇE PETROV DHE QENDËR

“Me futjen e “Butoni emergjent”, ne si komunë po forcojmë kujdesin për kategoritë më të rrezikuara të qytetarëve. Kushdo që ka nevojë për ndihmë do të jetë në gjendje ta marrë atë 24/7, me mbështetjen e ekipeve të trajnuara. Ky shërbim do të jetë plotësisht pa pagesë për shfrytëzuesit nga Komuna e Gjorçe Petrovit, pasi që ne i sigurojmë të gjitha mjetet financiare për realizimin e tij”, tha Stojkoski.

Komuna e Gjorçe Petrovit prezantonte shërbimin “Butoni emergjent”, me qëllim të mbështetjes së personave mbi 65 vjeç që jetojnë vetëm, si dhe personave të tjerë me shëndet të dobët dhe të sëmurë në territorin e saj. Shërbimi është promovuar më 3 shkurt të këtij viti nga kryetari i Komunës së Gjorçe Petrovit, Aleksandar Stojkoski, i cili theksoi se po realizohet në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Qytetit të Shkupit dhe se do t'u mundësojë përdoruesve të marrin ndihmë emergjente vetëm me shtypjen e një butoni.

“Me futjen e “Butoni emergjent”, ne si komunë po forcojmë kujdesin për kategoritë më të rrezikuara të qytetarëve. Kushdo që ka nevojë për ndihmë do të jetë në gjendje ta marrë atë 24/7, me mbështetjen e ekipeve të trajnuara. Ky shërbim do të jetë plotë-

sisht pa pagesë për shfrytëzuesit nga Komuna e Gjorçe Petrovit, pasi që ne i sigurojmë të gjitha mjetet financiare për realizimin e tij”, tha Stojkoski.

Nga komuna thonë se, përmes këtij shërbimi, përdoruesit do të kenë mundësi: të marrin mbështetje emergjente në çdo kohë që kanë nevojë; të jetë në kontakt me operatorë profesionistë, të cilët do t'u japin udhëzime për veprime të mëtejshme; të marrin ndihmën e parë mjekësore ose psikologjike, si dhe transportin në institucionin përkatës shëndetësor, por kanë edhe mirëmbajtjen teknike falas të aparatit të alarmit. Të gjithë banorët e Komunës së Gjorçe Petrovit të cilët jetojnë vetëm dhe kanë probleme shëndetësore mund të regjistrohen në shërbimin në numrin 076 212 329 ose me email: m.saraginov@opstinagpetrov.gov.mk.

Thirrja publike për aplikime për shërbimin “Butoni emergjent” në Komunën Qendër është duke vazhduar. Siç njoftojnë nga Komuna Qendër, ky shërbim i ri u ofron qytetarëve të moshuar mbi 65 vjeç ndihmë në situata emergjente, në shtëpi, në dispozicion 24/7 gjatë gjithë vitit. “Në thirrjen publike mund të aplikojnë banorët mbi moshën 65 vjeçare nga Komuna Qendër, me përparësi personat që jetojnë vetëm ose me bashkëshortë me gjendje të komprometuar shëndetësore. Përdoruesit që dëshirojnë të regjistrohen duhet të kenë adresën e vendbanimit në Komunën Qendër, të mos kalojnë pensionin prej 35.000 mijë denarë dhe të jenë persona të cilët nuk janë diagnostikuar me demencë, pasi aparati nuk është i përshtatshëm për personat me demencë



dhe sëmundje Alzheimer. Ky shërbim është falas dhe mund të përdoret vetëm nga një anëtar i familjes”, bëjnë të ditur shërbimi për shtyp i komunës.

Komuna sqaron se banorët e moshuar mund të aplikojnë duke plotësuar një kërkesë për të përdorur shërbimin e Butonit emergjent, e cila plotësohet gjatë aplikimit në zyrën e Kryqit të Kuq, me një kopje të letërnjoftimit dhe një kopje të çekut të fundit të pensionit. Banorët e interesuar mund të dorëzojnë të gjitha dokumentet në zyrën e Butonit emergjent në rrugën “Sllave Georgievski Shnairder” nr. 5, çdo ditë pune nga ora 08:00-16:00. Çdo dërgesë e dokumenteve duhet të planifikohet pa-

raprakisht duke telefonuar në numrin 02/15330. Për shkak të një numri të kufizuar pajisjesh, përdoruesit do të zgjidhen sipas parimit i pari shërbehet.

Kryetari i Komunës së Qendrës, Goran Gerasimovski, thekson se të moshuarit e Komunës Qendër mund të marrin ndihmë emergjente thjesht duke shtypur butonin e pajisjes komunikuese, e cila mbahet si varëse në formë byzylyku ose gjerdani.

-Pas aktivizimit të butonit, sinjali arrin në Kryqin e Kuq ku personat përgjegjës kontaktojnë përdoruesin që ka nevojë për ndihmë emergjente dhe më pas në varësi të situatës dërgohet një ekip në terren ose thirret ndihma emergjente.



## Seanca e BOR-s

Kryetare e re e Bordit të organizatës së regjistruar për fond solidariteti dhe anëtarësim është zgjedhur Snezhana Andova, ndërsa nënkryetar Stevan Aceski. Në seancën e Bordit të Organizatës së regjistruar për fond solidariteti dhe anëtarësim (BOR), me propozim të kryetares së Lidhjes së Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë, për kryetare të re të Bordit u zgjodh Snezhana Andova, ekonomiste me përvojë shumëvjeçare para pensionimit dhe aktiviste e shquar në zhvillimin e organizimit të pensionistëve. Ajo u zgjodh në vend të Mentor Qokut, nënkryetar i mëparshëm i KE të LSHPM-së.

Zëvendësi i saj, përkatësisht nënkryetar i BOR-së, u zgjodh Stevan Aceski, me profesion jurist, njëherazi aktivist në LSHPM me përvojë dhe njohuri për punën e organeve të Sindikatës dhe organizatës së pensionistëve.

Të dy janë anëtarë aktualë të Bordit të organizatës së regjistruar të fondit të solidaritetit dhe organizatës së anëtarësimit. Anëtar i ri i BOR-së u zgjodh Ilija Ivanovski, gjithashtu aktivist në pension me njohuri për punën e BOR-së. Anëtare e këtij organi mbetet Danica Petličkova, si dhe kryetarët e shoqatave të tjera të pensionistëve me aftësi të kufizuara në Maqedoni. Kryetari dhe nënkryetari i sapozgjedhur falënderuan për besimin e dhënë dhe premtuan se do ta kryejnë detyrën me kënaqësi dhe përgjegjësi sepse puna e këtij organi është e një rëndësie të veçantë për pensionistët, anëtarë të LSHPM-së.

## Mendo Alin!

Edhe një vit dhe ai do të kalojë të nëntëdhjetat të jetës së tij. Dhe kjo nuk është interesante për këtë zotëri të moshuar!

Mendo Alin do ta takoni çdo mëngjes në stacionin e autobusit në një nga lagjet Fushës së Topanës, duke prituri me durim autobusin rreth orës 7:30. Ai është gjithmonë i rregulluar dhe i paraqitshëm. Kur arrin, përshëndet me mirësjellje fqinjët që presin në stacionin e autobusëve. Kur e pyeta se çfarë kombësie ka, më tha, “Unë jam maqedonas, një shkupjan i vjetër, përndryshe jam turk.

Kush është Mendo Alin?

Mendo Alin me profesion është berber. Dyqani ku punon edhe sot, pavarësisht viteve, ndodhet në Çarshinë e Vjetër të Shkupit, një nga më të mëdhatë të ndërtuar jashtë Turqisë në kohën e “Perandorisë Osmane”, dhe që thotë se ndahej në disa pjesë sipas asaj që bëhej në çarshi. Kishte një teneqexhi, një jorganxhi, një farkëtar, një regjës lëkurësh, një bojëxhi, një seksion me shitës fruta-perimesh, me shitës sendesh të imta, qiçra... Kishte edhe shumë xhami në të. Dyqani ku punon sot Mendo është në pronësi të tyre prej 75 vitesh. Nuk ka asnjë vend ku Mendo të mos ketë punuar: në të gjithë ish-Jugosllavinë, por edhe në disa vende të Afrikës Veriore. Shumë gazeta shkruanin për të... Flet maqedon-

nisht, turqisht, shqip, gjuuhën rome, serbisht... Shumë gjuhë. “Duhet. Puna e kërkon atë. Njerëz të të gjitha kombeve dhe besimeve vijnë te berberi. Berberët dikur nuk ishin vetëm berberë. Ata ishin edhe xharrahë, nxirrnin dhëmbë, mjekonin tullacën dhe lironin gjak me shushunja. Unë gjithashtu kam mbledhur shushunjat. Tani ata janë zhdukur sepse nuk ka shamak në zonën përreth Shkupit. Janë shushunja të veçanta, shumëgjyrëshe”, kujton Mendo.

Edhe unë e mbaj mend. Dikur në rrethinën e Shkupit kishte edhe lejlekë, bretkosat kërcatisnin, dëgjoheshin zogj... sidomos në lagjen tashmë elitare të Shkupit “Lisiçe e Re”. Aty ka qenë një moçal. Kishte edhe kopshte... Tani aty ka vetëm ndërtesa. Dhe Fusha e Topanës nuk është ajo që ka qenë. Dikur lagje gazmore, tani nuk është kështu. Nuk ka dasma pas tre-katër ditësh ku të gjithë kërcëjnë, nuk dërgohen njerëz në qilima në Kala për festën e Shën Gjergjit, as nuk ka kolona me karroca fshatare që shkojnë në ndonjë nga manastiret e Ilindenit, veçanërisht në manastirin “Shën Ilija”.

Tani për të ditur se ndokënd e ke fqinj, e merr vesh duke prituri autobusin. Ju pyesni veten pse dikush jeton në rrugën tuaj ose në ndërtesën ngjitur dhe nuk e keni parë kurrë. E merr vesh se ka vdekur komshia që jeton mbi ty



dhe nuk e kupton. Ishte e frikshme kur prisnim një orë e gjysmë autobusin, por të paktën u njohëm dhe kush ishim dhe ku jetonim, çfarë bënim... Por kthehemi te Mendo.

“Kam katër fëmijë. Janë të gjithë njerëz të ditur dhe të shkolluar me titujt më të lartë: magjistër, doktorë shkencash, shkencëtarë, doktorë... Ata jetojnë në vende të ndryshme të shpërndara nëpër botë. Edhe nipërit e mi janë njerëz të ditur. Unë jam berber. Është një zanat i bukur. Në të kaluarën nuk kishte internet, celular, rrjete sociale... Lajmi i parë është dëgjuar tek një berber. Pastaj u ndanë. Kishte edhe respekt më të madh në popull. Çdo gjë është ndryshe tani. Mbërrita. Mirupafshim”, thotë Mendo dhe zbrit në stacionin e autobusit afër Bit Pazarit. Vrapon në dyqanin e Çarshisë që të mos vonohet dhe e hap në kohë, siç e ka zakon. Kalina S. Andonova